

VENDIM
Nr. 95, datë 16.12.2015

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË
SHITESË NGA BANKA NBG ALBANIA SHA**

Në bazë të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, dhe nenit 54, pika 2, shkronja “dh”, nënpika “v”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka NBG Albania sh.a., të veprimtarisë financiare shitesë, si më poshtë:

- tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe të letrave me vlerë të transferueshme.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të bëjë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës NBG Albania sh.a., në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko